



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

R R E G U L L O R E

**PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT**

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (Këtu e në vijim KKT), si dhe për adminstrimin e dokumentacionit bazuar në parimet e zbatimit korrekt të legjislacionit në fuqi, të rritjes së cilësisë dhe shpejtësisë së vendimmarrjes dhe transparencës ndaj publikut.

Neni 2

Baza juridike për funksionimin dhe organizimin e KKT-së.

KKT funksionon dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën, me Ligjin Nr. 10019, datë 23.04.2009, “Për planifikimin e territorit” i ndryshuar, me VKM-në nr. 1190, datë 13.11.2009 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AKPT-së”,VKM nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në adminstratën publike” me akte të tjera ligjore dhe nënligjore, si dhe me këtë rregullore.

Neni 3

Objekti i rregullores

Objekt i kësaj rregulloreje janë:

- a. Struktura, drejtimi dhe veprimtaria e KKT-së;

- b. Marrëdhëniet midis Sekretariatit të KKT me Zëvendës Kryetarin dhe Kryetarin e KKT-së;
- c. Marrëdhëniet e Strukturave të Sekretariatit të KKT-së me publikun, mediat apo subjektet e tjera që i drejtohen KKT-së.

Neni 4

Parimet e veprimtarisë

- 1. Në veprimtarinë e tij, KKT respekton parimet e:
 - a. Zhvillimit të qëndrueshëm, ekonomik dhe social, i cili përcakton vizionin për zhvillimin e ardhshëm të territorit;
 - b. Bashkërendimin horizontal e vertikal ndërmjet autoriteteve kombëtare e vendore të planifikimit dhe palëve të interesuara;
 - c. Shumëllojshmërisë;
 - d. Planifikimit të detyrueshëm për të gjitha autoritetet e planifikimit;
 - e. Vazhdimësisë;
 - f. Transparencës;
 - g. Përdorimit të territorit.
- 2. Në veprimtarinë e tij, KKT zbaton kërkesat e legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.

Neni 5

Organizimi

- 1. KKT është organ kolegjal që funksionon pranë Këshillit të Ministrave. Kryeministri është Kryetar i KKT-së. KKT përbëhet nga Kryetari, Zëvendës Kryetari dhe nga 9 anëtarët, emëruar sipas VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”.
- 2. KKT është organi vendimmarrës përgjegjës për miratimin e:
 - a. Instrumenteve kombëtare të planifikimit të territorit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009, “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar;
 - b. Përcaktimit të rëndësisë kombëtare të një çështjeje në planifikimin e territorit;
 - c. Shqyrtimin dhe miratimin e përputhshmërisë së instrumentit të përgjithshëm vendor me instrumentin e planifikimit në fuqi;
 - d. Nxiti hartimin e planeve territoriale kombëtare e vendore nga autoritetet përkatëse të planifikimit dhe siguron që ato të përmbushin standartet teknike e procedurale të përcaktuara në ligjin e planifikimit;
 - e. Kërkesave për zhvillim dhe lejet e ndërtimit: në zonat kombëtare, prona shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore, oborre që përdoren për shërbime të ofruara nga shteti për arsimin dhe shëndetësinë;
 - f. Kërkesave për leje zhvillimore komplekse brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me propozimin e Ministrit të Linjës;
 - g. Shqyrtimin në mënyrë përfundimtare dhe miratimin e planeve zhvillimore dhe rregulluese të bashkive të kategorisë së parë në territorin e vendit.

Neni 6

Drejtimi i KKT-së

Kryetari drejton mbledhjet e KKT-së. Në mungesë e me porosi të tij, mbledhjet drejtohen nga Zëvendës Kryetari.

Neni 7

Njoftimi i mbledhjeve

Njoftimi për mbledhjet e KKT-së duhet t'u bëhet anëtarëve të paktën 2 ditë përpara datës së zhvillimit të tyre. Njoftimi duhet të publikohet në regjistër të paktën 24 orë përpara datës së zhvillimit të mbledhjeve.

Neni 8

Rendi i ditës

Mbledhjet e KKT-së zhvillohen në bazë të një rendi dite të përcaktuar nga Kryetari me propozim të Sekretarit dhe Zëvendës Kryetarit të KKT-së. Në mungesë të Kryetarit, Zëvendës Kryetari vendos për rendin e ditës.

Në rendin e ditës përfshihen:

- a. Çështjet e propozuara nga Sekretari dhe Zëvendës Kryetari i KKT-së.
- b. Materialet bashkëlidhur për çdo çështje që do të diskutohen në mbledhje.

Njoftimi i çdo anëtari drejtuar Kryetarit për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 3 (tre) ditë përpara thirrjes së mbledhjeve.

Rendi i ditës duhet t'u njoftohet me shkrim anëtarëve të KKT-së, të paktën 2 (dy) ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjeve.

Neni 9

Mbledhjet dhe votimi

1. KKT mbledhet si rregull, të paktën 1 (një) herë në muaj. Në rastet kur është e nevojshme në zbatim të ligjit ose shihet e arsyeshme, Kryetari mund të thërrasë mbledhjet e KKT-së dhe jashtë rradhe.
2. Sekretariati i KKT-së (AKPT) merr masat duke njoftuar me shkrim për thirrjen e mbledhjeve të KKT-së.
3. Mbledhjet e KKT-së janë të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij, një prej të cilëve duhet të jetë Kryetari ose Zëvendës Kryetari.
4. KKT vendos për çështjet e diskutuara me shumicë të cilësuar, me 2/3 e votave të anëtarëve. Anëtarët e KKT-së nuk mund të abstenojnë.
5. Në mbledhjet e KKT-së, sipas objektit dhe materialit që do të shqyrtohet, ftohen të marrin pjesë pa të drejtë vote Autoriteti/Subjekti kërkues, Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, përfaqësues nga institucione shtetërore të interesuara, autorë të projektit,

përfaqësues nga shoqatat e Arkitektëve, Planifikuesve Urbanë, Ndërtuesve, Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme, Topografëve etj.

6. Në mbledhjet e KKT-së, përveçse mbi çështjet e rendit të ditës, mund të merren vendime dhe mbi çështje të tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë e KKT-së.
7. KKT ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar i Territorit”, në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi. Vula zyrtare e KKT-së, ka formën dhe elementët e përcaktuara në pikën 2 të vendimit Nr. 390 datë 06.08.1993 të Këshillit të Ministrave “ Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare” të ndryshuar. Vula e KKT-së, prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Vendimet e KKT-së

KKT merr vendime në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi të përcaktuara në nenin 2 të kësaj rregulloreje si dhe të ligjeve të posaçme në fuqi.

KKT në përfundim të diskutimit / shqyrtimit të çdo çështjeje, sipas përcaktimit të nenit 5, pika 2 vendos:

- a. Miratimin e materialit;
- b. Miratimin me ndryshime të materialit;
- c. Miratimin e pjesshmëm të materialit;
- d. Shtyrjen për shqyrtim të mëvonshëm të materialit;
- e. Refuzimin e shqyrtimit të materialit;
- f. Mosmiratimin e materialit.

Neni 11

Përmbajtja e vendimit

1. Vendimi i KKT-së përmban numrin, datën, nënshkrimin e Kryetarit, Zëvendës Kryetarit, të Sekretarisë, si dhe vulën e KKT-së.
2. Vendimi përmban emërtimin e llojit të Instrumentit apo Lejes që miratohet.
3. Vendimi përmban emrin e Autoritetit të Planifikimit, subjektit apo personave fizikë, të cilëve ju është miratuar Instrumenti apo Leja.

Neni 12

Veprimtaria e Sekretariatit të KKT-së

1. AKPT kryen funksionet e Sekretariatit Teknik të KKT-së, në organizimin e mbledhjeve si dhe përgatit dhe administron dokumentacionin që shqyrtohet në mbledhjet e KKT-së.
2. AKPT krijon, për çdo mbledhje të KKT-së, një dosje të posaçme, në të cilën përfshihen përveç materialeve të mbledhjeve dhe procesverballi i mbledhjeve.

3. AKPT merr masa për krijimin e kushteve të nevojshme në sallën e mbledhjeve, përzgjedhur për këtë qëllim apo çdo ambient tjetër ku zhvillohet mbledhja e KKT-së, si dhe kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm në funksion të zhvillimit normal të mbledhjeve.
4. Ushtron kujdesin e duhur që gjatë organizimit të mbledhjes, të respektohet rëndësia e mbledhjeve, duke zbatuar të gjitha urdhërat apo porositë e Kryetarit të KKT-së ose Zëvendës Kryetarit, kur ky i fundit drejton mbledhjen e KKT-së.
5. Mbledh dhe përpilon të dhëna statistikore periodike mbi veprimtarinë e mbledhjeve të KKT-së.
6. Komunikon vendimet pas përfundimit të mbledhjeve, subjekteve objekt i vendimmarrjes për vendimet e marra nga KKT në mbledhje.
7. Mban procesverbalin e mbledhjeve të KKT-së në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe merr masat e duhura për regjistrimin zazor të tyre.
8. Transkripton procesverbalin e mbledhjeve të KKT-së në formatin e duhur. Transkriptimi mundësohet nga dëgjimi i CD-ve pas mbarimit të çdo mbledhjeje.

Neni 13

Sekretari i KKT-së

Sekretari i KKT-së është Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), i cili drejton dhe organizon veprimtarinë e Sekretariatit të KKT-së sipas legjislacionit në fuqi dhe kësaj rregulloreje.

Neni 14

Përfaqësimi ligjor i KKT-së

AKPT (Sekretariati teknik i KKT-së) përfaqëson dhe mbështet KKT-në nga ana teknike në mosmarreveshjet e lindura gjatë zbatimit të vendimeve të marra nga KKT. AKPT nuk mban përgjegjësi për detyrimet financiare që rrjedhin nga vendimmarrjet e KKT-së.

Neni 15

Publikimi në regjistër

Vendimet e KKT-së publikohen në regjistër pas konfirmimit të tyre nga Kryetari i KKT-së.

Neni 16

Arkivimi dhe ruajtja e dokumentacionit

Vendimet e KKT-së, pas konfirmimit të tyre nga Kryetari ju shpërndahen nga 1 kopje institucioneve si më poshtë:

- Arkivit të Këshillit të Ministrave;
- Arkivit të AKPT-së;

- Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- Ministrisë së Drejtësisë;
- Ministrisë së Kulturës;
- Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë;
- Ministrisë së Bujëqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
- Ministrisë së Mjedisit;
- Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit;
- Njësi përkatese të qeverisjes vendore;
- Autoritetit përgjegjës për hartimin e instrumentit të planifikimit dhe/ose të kontrollit të zhvillimit;
- Aplikuesit për leje për punime që miratohen në KKT;
- Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar;
- Institucioneve dhe organeve shtetërore që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e instrumenteve të planifikimit dhe/ose të kontrollit të zhvillimit të shqyrtuara në KKT.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.